



# **Partia Rome e Bashkuar e Kosovës**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur**

**01 Janar 2013 - 31 Dhjetor 2013**



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3-6
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-11

# Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partia Rome e Bashkuar e Kosovës

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për te audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Partia e Bashkuar e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekt i Politik” apo “PREBK”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2013, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionet tjera shpjeguese.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Partia Rome e Bashkuar e Kosovës. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

### Bazat për mohim të Opinionit

- Siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare te bashkëngjitur, detyrimet dhe fondet e subjektit politik tejkalojnë asetet e SP për 1,192.96 euro si pasoj ka një mos barazim ne mes te asetëve të prezantuara dhe burimeve te financimit, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që ka mbajtur PREBK ne e kishim te pamundur te përcaktojmë nëse SP ka mbivlerësuar burimet e financimit apo ka nënvlerësuar asetet e prezantuara.
- Subjekt i nuk ka prezantuar gjendjen e parasë së disponueshme në bankë në shumën prej 4,471.78 euro me 31 Dhjetor 2013 (12,143.76 euro; 31 Dhjetor 2012) në Pasqyrën e Pozicionit Financiar duke nënvlerësuar kështu gjendjen e parasë dhe ekuivalentëve të parasë me 31 Dhjetor 2013.
- Ashtu siç është prezantuar ne pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve, SP ka deklaruar te hyra nga buxheti në shumën prej 32,000.00 Euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që Subjekt i politik ka mbivlerësuar të hyrat e raportuara nga buxheti për vitin 2013 për shumën prej 500.00 euro.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 “Shpenzimet”, Subjekt i Politik ka deklaruar shpenzime nga pagat dhe kompensimet në shumën prej 15,800.72 Euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013, në mungesë te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te konstatojmë nëse shpenzimet e deklaruara janë te sakta.
- Subjekt i Politik nuk ka prezantuar te hyra dhe shpenzime për vitin krahasues 2012 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, edhe pse SP ka zhvilluar aktivitetet përgjatë këtij viti.

- Subjekti politik nuk ka raportuar të hyrat nga donacionet në të holla të datës 20 Shkurt 2013 nga personi fizik në vlerë prej 1,000.00 euro duke nënvlerësuar kështu Të hyrat nga Donacionet në të holla, dhe duke mos i raportuar ato ne kundërshtim me kërkesat ligjore të ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 “Shpenzimet”, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime në shumën totale prej 33,192.96 Euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik ka nëndeklaruar shpenzimet e vitit të raportuara për shumën prej 3,212.25 euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013.

### **Theksim i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë),

shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë



mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

---

Fatmir Mehmeti  
Auditor Ligjor  
28 Nëntor 2017

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>		<b>Me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2012</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>	Shënimi	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë			
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar			
Suficiti / (deficiti) i vitit		(1,192.96)	
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>(1,192.96)</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera			
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra			
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>(1,192.96)</b>	<b>0.00</b>

Pasqyrat Financiare të Subjektit Politik janë aprovuar nga kryesia me 1 Mars 2014,

Ztr. Albert Kinolli  
Kryetar

Ztr.  
Zyrtar Financiar

**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2013	2012
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		32,000.00	
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		0.00	
Të hyrat e fushatës		0.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		0.00	
Të hyrat tjera			
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>32,000.00</b>	
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompenzimet	2	15,800.72	
Shpenzimet e transportit	2	7,165.20	
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	6,627.04	
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	
Blerja e mallrave	2	2,700.00	
Shpenzimet e përgjithshme	2	0.00	
Shpenzimet e ndryshme	2	900.00	
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>33,192.96</b>	
<b>Suficiti (+) ose deficit (-) për vitin</b>		<b>(1,192.96)</b>	



## **1. Informata te përgjithshme**

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës me seli në Prizeren , Kosovë.

Udhëheqja: Albert Kinolli (Kryetar i partisë)

Themelues: Haxhi Merxha

Themeluar :Korrik,2001

Aktiviteti kryesore: Aktivitetet e organizatave politike

Pasqyrat financiare Partia Rome e Bashkuar janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari të vetme bankare në bankën RBKO.

**Shënimi 2: Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompenzimet</b>			
Pagat dhe kompenzimet, neto	14,576.00	14,576.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	393.24	393.24	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	393.24	393.24	0.00
Tatimet në të ardhura personale	438.24	438.24	0.00
Beneficionet tjera			0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>15,800.72</b>	<b>15,800.72</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	6,835.20	6,835.20	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	330.00	330.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>7,165.20</b>	<b>7,165.20</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali			0.00
Ushqimi	4,917.04	4,917.04	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	1,710.00	1,710.00	0.00
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>6,627.04</b>	<b>6,627.04</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës			0.00

**Partia Rome e Bashkuar e Kosovës**

*Pasqyrat Financiare 01 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013*

<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	2,700.00	2,700.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>2,700.00</b>	<b>2,700.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës			0.00
Telefoni, interneti dhe posta			0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00	////////////////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	900.00	900.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>900.00</b>	<b>900.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>			
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>33,192.96</b>	<b>33,192.96</b>	<b>0.00</b>